

Edhe përkundër paralajmërimit të krizës

Dru me bollëk, çmimet si vjet

Në Kumanovë nëpër depo ka mbi një mijë metra kub dru, kurse çmimi mesatar për një metër është 2.380 denarë. Në ndërkohë paralajmërojnë se mund të ketë edhe ulje çmimesh. Në dhjetëra depo private çmimi i ahut kushton 2.600 denarë, kurse i bungut 2.800

Koha Emine AQIFI

Kumanovë, 31 gusht - Edhe përkundër paralajmërimeve të javëve të fundit se do të ketë shtrenjtime edhe të druve dhe se mund të ketë edhe krizë për dru, megjithatë në qytetin e Kumanovës, për momentin një gjë e këtillë nuk vërehet. Çmimet e druve janë të njëjta sikurse dy - tre vjetët e fundit dhe dru ka me bollëk si në Ekonominë e pyjeve poashtu edhe nëpër depot private.

"Krizë për dru nuk do të ketë, Ekonomia e pyjeve-njësia në Kumanovë disponon me sasi të mjaftueshme të druve dhe realisht i mbulon kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Aktualisht në depot e tona kemi mbi 1.000 metra kub dru. Çmimi mesatar i një metër kub dru kushton 2.380 denarë. Qytetarët vijnë, interesohehen, i shikojnë drunjët, ata



që kanë para i blejnë menjëherë e të tjerët e lënë për më vonë. Me një fjalë dru ka me bollëk dhe nuk do të ketë kurrfarë krize. Presim që çmimet e druve të ulen, por për këtë presim vendimin e qeverisë. Kjo do të thotë se mund të pritet riformim i çmimeve shitëse të druve gjithashtu qytetarët i sigurojë se druve tanë janë të cilësisë së lartë dhe gjithsesi me çmime më të ulëta se gjithkund", na tha Vaid Saiti, drejtor i NP "Ekonomia e pyjeve" - njësia në Kumanovë. Nga ana tjetër edhe në depot private druve ka me bollëk, kurse çmimet mesatar-

isht sillen prej 2.600 denarë për një metër druve të ahut deri në 2.800 denarë për ato të bungut. Edhe nëpër depot private thonë se dru ka për momentin dhe realisht nuk mund të pritet ndonjë krizë pasi ka me bollëk. Edhe përkundër faktit se gjatë kësaj vere nga zjarret e shumta kishim shkurbimin e qindra hektarëve me pyje në Malësinë e Karadakut, megjithatë aktualisht nuk vërehet kriza e druve.

"E vërtetë është se sivjet nga zjarret e shumta u shkurbuan qindra hektarë me pyje të lloj -llojshme në Karadakun e Kumanovës,



VAID SAITI

"E vërtetë është se sivjet nga zjarret e shumta u shkurbuan qindra hektarë me pyje të lloj -llojshme në Karadakun e Kumanovës, mirëpo falë rezerva që posedojmë nga viti i kaluar dhe vitet tjera depot tona janë të mbushura me dru."

mirëpo falë rezerva që posedojmë nga viti i kaluar dhe vitet tjera depot tona janë të mbushura me dru. Në këtë mënyrë në mëtojmë që të jemi në shërbim të qytetarëve si me çmime të kapshme po ashtu edhe me cilësinë e druve", na deklaroi Vaid Saiti.

Për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike, nga dhjetëra depo private në qytetin e Kumanovës, disa sish ofrojnë furnizim të druve edhe deri në tre këste, duke u mundësuar të gjitha kategorive të qytetarëve që me kohë të furnizohen me druve për djege. Megjithatë, pritet të shihet se si do të rrjedhin gjërat gjatë javëve në vijim kur edhe shtohen kërkesat për furnizim me druve.

Nga renovimi te integrimi multietnik

Ohër, 31 gusht - Shkolla fillore "Bratstvo-Migjeni" nga Tetova, me sukses ka zbatuar projektin për renovimin e dritareve, si pjesë e programit "Për integrimin ndëretnik në arsim", që u zhvillua me financimin e Agjencionit amerikan USAID dhe realizimin e "Qendrës Maqedonase për Edukim Qytetar" dhe participimin e pushtetit vendor të Tetovës, u potencua në Ohër, gjatë një punëtorie nga bartësit e këtij projekti. Adriana Rafaelloska, nga shkolla "Bratstvo-Migjeni", koordinatore e zbatimit në terren të këtij investimi, potencoi se ky program përveç asistencës në drejtim të renovimit të dritareve që ishte i mirëseardhur pati dhe dimensionin e kultivimit të integritetit ndëretnik dhe afrimit ndërmjet pedagogëve, prindërve dhe nxënësve Vesna Avramoska,



përfaqësues e pushtetit vendor të Tetovës, theksoi se Komuna e Tetovës kontribuoi me 50 % të financimit të këtij investimi. "Ne si komunë mbështetëm këtë projekt i cili në thelb ka integrimin dhe afrimin e ndërmjet komuniteteve dhe gjithmonë do të jemi në mbështetje të programeve që promovojnë këto vlera", thar Avramoska. Ndërkohë, Arif Ceka, drejtor në

shkollën "Bratstvo-Migjeni" tregon se me të dëgjuar për këtë projekt menjëherë ka angazhuar një ekip gjithëpërfshirës i cili ndoqi problematikën e aplikimit si dhe të realizimit të këtij investimi. Por, mbi të gjitha, sipas drejtorit, ky projekt ndikoi në afrimin ndëretnik dhe promovimin e vlerave më të mira të kooperimit. Ndërsa Hebil Selimi, përfaqësues i prindërve në Trupin

koordinues të këtij projekti nënvizoi efektin pozitiv në relacion të integritetit ndëretnik. "Ne jetojmë në lagje të përziera dhe pas vitit 2001 u ftohën marrëdhëniet ndëretnike dhe disa të rinj shkuan shumë larg. Por, ne duhet ta kthejmë besimin dhe të kontribuojmë dhe në këtë drejtim ky projekt ishte i mirë se ardhur", përfundoi ai. "Projekti për integrimin ndëretnik në arsim" ka filluar të realizohet prej vitit 2011 dhe deri tani ka përfshirë rreth 23 komuna dhe dhjetë shkolla. Qëllimi i këtij projekti është të nxitet krijimi i vetëdijes dhe të sigurohen trajnime të llojlojshme, ndihmë teknike dhe nxitjen për këshillat e shkollave, drejtorët e shkollave, arsimtarët dhe të punësuarit në komuna për mbështetjen të integritetit ndëretnik në arsim. (P.L.)

Kërçovë, 31 gusht - Zjarri që pat shpërthyer ditën e mërkurë ka djegur sipërfaqe të mëdha të mbjella me pisha në hapësirat në mes të fshatrave Zajaz dhe Drogomisht i Madh. Për të intervenuar në shuarjen e zjarrit, menjëherë kanë dalë ekipet e zjarrfikësve dhe ato të Ndërmarrjes që menaxhon me pyje "Llopushnik". Të enjten në ndihmë kanë mbërritur edhe avionët special, banorët vendor si dhe ushtarët e kazermës në Kërçovë. Ditë më parë zjarri u izolua, ndërsa të premtën gati është fikur, por sërish aty qëndrojnë roje për të mos lejuar shpërthimin e sërishëm. Akoma nuk dihen shkaqet



e zjarrit, por mendohet se ai është shkaktuar nga pakujdesia e njerëzve apo e ndonjë piromani. Është ky zjarri i dytë i këtij viti në rajonin e Kërçovës dhe

i treti po në të njëjtin mal me pisha. Kërçova mendojnë qytetarët ka shumë piromani pasi që në 5 vitet e kaluara janë djegur sipërfaqe të mëdha me

pyje edhe atë ky është rasti i 60 i djegies së maleve. Për të parandaluar këtë fatkeqësi dhe për të rritur efikasitetin e intervenimit, shtabi rajonal për menaxhim me krizat në Kërçovë, ka realizuar disa takime me strukturat e pushtetit vendor dhe ato te Njësia territoriale të zjarrfikësve ku këto te fundit gjithnjë kanë përsëritur mungesën e mekanizmave përkatës për ndërhyrje në terrenet e vështira malore. Qytetarët mendojnë se djegia e pishave është shkaktuar

me qëllim ngase kur këtu ka vepruar pushteti komunist nuk është regjistruar asnjë rast i djegies së pyjeve. "Ky është dëm i madh. T'ua vësh zjarrin pishave që na zbukurojnë dhe na falin ajër të shëndetshëm duhet të jesh kriminel. Këta kriminelë përse nuk dignin male kur vepronte sistemi komunist, se atëherë dihej që do vuanin burje, ndërsa tani asnjë nuk kujdeset që të zbulojë atë dorë piromani, andaj çdo vit sa herë iu duhen dru për shtëpia apo

Spitali i Dibrës me probleme kadrovike Mungojnë edhe infermiere

Dibër, 31 gusht - Aktualisht në Spitalin e Dibrës mungojnë mjekë të përgjithshëm, por edhe mjekë specialist. Ky spital i cili ka një epitotet rajonal, meqë këtu përveç pacientëve nga Dibra, mjekohen edhe pacientët nga Komuna Qendër Zhupë dhe rajoni i Rekës, aktualisht ka nevojë për përmirësimin të kuadrit shëndetësor. Sipas drejtorit të Spitalit të përgjithshëm, Baki Alili, si institucion shëndetësor sekondar, në shumë reparte siç janë kirurgjia, gjinekologjia, pediatria, por edhe njësia e rengenit dhe laboratorë kanë nevojë për kuadro të specializuara. Alili shton se janë ndërmarrë të gjithë aktivitetet që të mos vijë deri te mbyllja e reparteve. Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, ky institucion tenton që të përmbushë kuadrot e nevojshme. Duke marrë parasysh numrin e madh të pacientëve që mbulon ky spital, në të cilin shpesh herë shërbime shëndetësore kërkojnë edhe banorët të zonave kufitare të Shqipërisë, janë ndërmarrë aktivitetet që laboratorët të përforcohen me kuadro, meqë të dy njësitë kanë një numër të madh të pacientëve. Por, në këtë spital të përgjithshëm mungojnë edhe mjekë të përgjithshëm. Edhe në këtë drejtim janë ndërmarrë aktivitetet që kuadrot të punësohen, edhe pse në Dibër mungojnë edhe kuadro të kësaj sfere. Ky spital i cili ka objekte shumë të mira, ballafaqohet me kuadro profesionale. Edhe pse ka patur një kontinuitet në dërgimin e mjekëve të përgjithshëm në specializime në degët e ndryshme në Klinikën shtetërore të Shkupit, përsëri ka nevojë për specialistë. Duhet theksuar edhe faktin se kuadrot të cilët kohëve të fundit kanë dalë në pension dhe të cilët kanë patur një domethënie të madhe në këtë institucion shëndetësor, duhet të zëvendësohen sa më shpejt.

Në këtë spital mungojnë edhe infermiere në disa reparte. Problemet financiare nuk japin mundësi që të bëhen punësime të reja. Kuadrot aktuale pothuajse në të gjithë repartet kur bëhet fjalë për motrat medicinale mungojnë. Përveç problemit me kuadrot në këtë spital udhëheqja bën përpjekje që të përmirësojë edhe aparataturat aktuale. Drejtori Alili thotë se ka ndërmarrë aktivitetet për sigurimin e aparataturave të cilët duhet të plotësojnë standardet e nevojshme. Në spitalin e përgjithshëm thotë ai, kemi bërë kërkesa në adresë të Ministrisë së Shëndetësisë për të siguruar aparatet e nevojshme për disa reparte. Poashtu vazhdimisht mbajmë kontakte me donatorët, kryesisht mërgimtarë dibranë që punojnë në SHBA dhe shtet të Europës për të siguruar aparataturat e nevojshme. (V.S.)

Dëmet nuk dihen, por as piromani!

diçka tjetër dhe për t'i blerë falas ua vënë zjarrit. Në Komunën e Oslomesë zjarri ishte vënë në mes të pishave që tregon se është bërë me qëllim", shprehet Skender Bexheti, qytetar që ndihmonte në fikjen e zjarrit. Zjarri i shkaktuar në mes të fshatrave Zajaz e Drogomishtë edhe njëherë dëshmoi se nuk funksionojnë ekipe të mekanizuara të zjarrfikësve, andaj edhe pas dy ditësh zjarri ende nuk është nën kontroll. Përveç pakujdesisë së faktorit njeri dëshmi është mosfunksionimi i të gjithë atyre shtabeve dhe njësive si dhe ekipeve të zjarrfikësve. (S.H.)